



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 795/13 Prot.

Tiranë, më 16 .04 .2026

**VENDIM**

Nr. 30 Datë 16.04 2026

**“PËR  
NJË NDRYSHIM TË VENDIMIT TË BORDIT TË ADMINISTRIMIT NR 5 DATË  
13.01.2026 , DHE MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË NDRYSHUAR TË  
PROGRAMIT TË PËRBASHKËT MASTER I SHKENCAVE NË "SHKENCA  
SPORTIVE", ME DIPLOMË TË DYFISHTË, MIDIS UNIVERSITETIT TË  
SPORTEVE TË TIRANËS, FAKULTETIT TË SHKENCAVE TË LËVIZJES" DHE  
UNIVERSITETIT "CARLO BO" TË URBINOS NË ITALI”**

Mbështetur në nenin 3, 49 dhe 80 të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", Vendimin nr. 57 datë 29.01.2020 "Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës", Udhëzimin nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë", i ndryshuar, në nenin 7, 43 të Statutit të UST-së, në Rregulloren e UST-së neni 24, në Vendimin e Senatit Akademik nr. 46 datë 03.04.2026, Bordi i Administrimit në mbledhjen e dates 16.04.2026,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e ndryshimit të Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 5 datë 13.01.2026 (bashkëlidhur).
2. Miratimin e marrëveshjes së ndryshuar të programit të përbashkët Master i Shkencave në "Shkenca Sportive" me Universitetin "Carlo Bo" të Urbinos në Itali, (bashkëlidhur).
3. Nisjen e procedurave për aplikim për hapjen e programit të përbashkët Master i Shkencave në "Shkenca Sportive" me Universitetin "Carlo Bo" të Urbinos në Itali.
4. Miratimin e pagesave për profesoratin e ftuar për mbulimin e shpenzimeve të transportit fjetjes, dietës ditore si dhe pagesën për orë mësimdhënieje, sipas akteve rregullatore dhe marrëveshjes së miratuar.

5. Ky Vendim i përcillet për njohje dhe zbatim Administratorit të UST-së , FSHL-së, si dhe Drejtorisë Së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen [www.ust.edu.al](http://www.ust.edu.al).

**KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**Artur COBANI**

